



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Kamëz, më 02.05.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: *Blerje uji i pishëm për kopshtet dhe çerdhet*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

MALLRA, Kodi CPV: 41110000-3 uji i pishem

VLERA E FONDIT LIMIT:

3,750,000(tre milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “**Bashkia Kamëz**” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

Argumentimi: kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulary percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (**2021,2022,2023**) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

2.2.2 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare përkatësisht (**2021,2022,2023**) në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij. (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.3 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2023**, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, *nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.*

Argumentimi: Kriteri i pikës 2.2.3 u vendos në referencë te nenit 76, pika 2 të ligjit 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" dhe konkretisht në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në KREU II, Taksat Vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin E Taksave Vendore, (i ndryshuar).

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur furnizimet e ngjashmë janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate;

ose

b-Kur furnizimet e ngjashmë janë realizuar me subjekte private, si dëshmi pranohen vetem faturat tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe te deklaruar ne organet tatimore ku shenohen data, shumat dhe sherbimet e realizuara.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marre ne konsiderate sasine dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, eshte menduar se vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete bere me kontrata te ngjashme, te jete afer limitit maksimal dhe ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

2.3.2.Operatori Ekonomik duhet të paraqesë çertifikatë konformiteti të lëshuar nga një institucion i akredituar për:

- a. Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë EN ISO 9001:2015
- b. Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit EN ISO 14001:2015
- c. Sistemin e Menaxhimit të Siurisë Ushqimore EN ISO 22000:2005.

Argumentimi: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40 pika 6, nenit 44, pika 1, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për te kryer sherbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatori ekonomikë qe do te ofertoje te jete i pajisur me certifikaten e menaxhimit te cilesise gje e cila krijon bindjen dhe sigurine e A.K. qe ky OE do te ofertoje produkte te certifikuara te nje cilesie te mire e ne perputhje me standartete nderkombetare te cilesise.

Kerkesa per certifikime sipas standardeve ISO jane ne vetvete nje garanci me teper per suksesin e projektit, ne lidhje me cilesine e produktit dhe sherbimeve,

2.3.3.Operatori Ekonomik duhet të paraqesë fletë-analizën fiziko-kimike dhe mikrobiologjike të ujit, Brenda normave të lejuara, lëshuar nga Drejtoria e Shëndetit Publik, si dhe analizën fiziko-kimike dhe mikrobiologjike të ujit të burimit, lëshuar nga Insituti I Shëndetit Publik.

Analizat duhet të jenë lëshuar gjatë muajit të fundit.

Argumentimi: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40 pika 6, nenit 44, pika 1, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021,

2.3.4.Operatori Ekonomik duhet të ketë aparate shpërndarës për përdorim gjatë periudhës së furnizimit me të pajisur 2 (dy) rubineta me systemin ngrohës dhe ftohës. Rubinetat duhet të jenë me sensorë. Gjithashtu aparatet duhet të jenë të pajisur me frigoriferë.

Argumentimi: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40 pika 6, nenit 44, pika 1, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne baze të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021,

2.3.5.Operatori Ekonomik ofrues duhet të ketë në listëpagesën e tij për periudhën **Janar 2024 - Mars 2024**, minimalisht **6 (gjashtë) punonjës**.

Argumentimi: Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin

datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

*Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpigjet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim **te paktën 6 (gjashtë) punonjës**..*

2.3.6.Operatoi Ekonomik ofertues duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) stabiliment prodhimi dhe të paktën 1 (një) ambient magazinimi me sipërfaqe minimale 30 m², me qëllim prodhimin dhe magazinimin e mallit objekt kontrate, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a. Dokument që vërteton pronësinë ose qiramarrjen.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë ambient magazinimi per te deshmuar realizimin me sukses te objektit te kontratës,

2.3.7. Operatori Ekonomik ofertues duhet të provojë se disponon në pronësinë e tij ose me anë të qiramarrjes të paktën 4 (katër) automjete transporti me kapacitet mbajtës 3.5 ton për transportin e mallit object kontrate. (Çertifikatë pronësie apo kontrate).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë përmbushjen e kontratës, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit

2.3.8. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën e konformitetit të ambalazhit (bidona 19 lit. lëshuar nga prodhuesi dhe çertifikatën e konformitetit për aparatën (dispenser) lëshuar nga prodhuesi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë çertifikatën e konformitetit, që i shërbejnë objektit të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njesia e Prokurimit

